

VENDIM
Nr. 763, datë 12.12.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË
PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT NË NJËSITË
TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 5/1, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit e njësive teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtimisht, deri në datën 1 janar 2023, masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për nëpunësit e përcaktuar në rreshtat 4 dhe 6, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të jetë përkatësisht, 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj dhe 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 nëntor 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku